



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:154120
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05353495

Ac.nr.6311/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit B.Sh., nga Ferizaji, Rr. “Gjon Sereçi” nr.6, të cilin me autorizim e përfaqëson B.S., avokat nga Ferizaji, kundër të paditurve I.Sh., dhe I.Sh., që të dy nga fshati F....., Komuna Shtërpcë, të cilët me autorizim i përfaqëson B.Q., avokat nga Ferizaji, në çështjen për pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpcë, C.nr.18/2019 të datës 27.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditësit B.Sh., nga Ferizaji, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpcë, C.nr.18/2019 i datës 27.01.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.18/2019 të datës 27.01.2023, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit B.Sh., nga Ferizaji, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit I., dhe I.S., që të dy nga fshati F....., Komuna Shtërpcë, kanë kryer aktin e pengim posedimit me dt.03.03.2019, në dëm të paditësit, ashtu që kanë vendosur tuba të kanalizimit nga ngastra e tyre me nr.XXX-X, në ngastrën e paditësit me nr.XXX-X, të regjistruara në qertifikatë P-XXXXX-XX-XX-X, nr.XXX/19 e dt.07.03.2019, ZK Drekoc, dhe kështu pengoi shfrytëzimin e qetë dhe faktik të palujtshmërisë së tij, ndaj atyre u kërkohet t’i heqin ato brenda tri ditëve dhe në të ardhmen të mos ndërhyjnë në shfrytëzimin e qetë të palujtshmërisë, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm. Në pikën dy e ka obliguar paditësin që të paditurve t’ua paguaj shpenzimet e

procedurës në shumë prej 1,122.00 Euro, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të aktvendimit, nën kërcënimin përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, të anuloj aktvendimin ankimor dhe të vendos me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, ose ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve përmes përgjigjes në ankesë, ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet, dhe të obligohet paditësi që të paditurve t'ia kompensoj shumën prej 156.00 euro në emër të përpilimit të kësaj parashtrere, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij me datë 08.03.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi ndaj të paditurve, për pengim posedimi. Në padi ka theksuar se akti i pengim posedimit konsiston në faktin se të paditurit e kanë penguar paditësin, ashtu që me rrjetin e kanalizimit i cili kalon përmes ngastrës së paditësit me nr. XXX-X, e pengon atë në shfrytëzimin në mënyrën e qetë siç e ka pas më parë, aktin e pengimit e ka vërejtur me datë 03.03.2019, kur e ka vizituar pronën e tij dhe nuk e din se nga kush janë vendosur tubat e kanalizimit. Në seancën e datës 21.10.2019, i autorizuari i paditësit e ka bërë precizimin-zgjerimin e kërkesës, duke kërkuar që pranë kërkesës ekzistuese për pengim posedim, të paditurit të detyrohen të lirojnë pjesën e uzurpuar të pronës që ka të bëjë me heqjen e tubave të kanalizimit.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore pas administrimit dhe shqyrtimit të provave, me aktvendimin C.nr.18/2019 të datës 27.01.2023, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit ankimor.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe i hartuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 160, lidhur me nenin 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në anën tjetër, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, ndërsa nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në procedurën për shkak të pengim posedimit si objekt shqyrtimit është mbrojtja e posedimit nga marrja dhe shqetësimi si dhe rivendosja e gjendjes së posedimit. Kjo do të thotë se me padi për pengim posedim mbajtësi faktik i sendit mund të kërkojë nga gjykata që të vërtetojë ekzistimin e aktit të pengim posedimit të sendit apo të së drejtës, që ta urdhërojë të paditurin që të rivendosë gjendjen e posedimit, ashtu siç ka qenë para kryerjes së aktit të pengim posedimit dhe ti ndalojë të paditurit ndërmarrjen e veprimit të njëjtë apo të ngjashëm në të ardhmen. Në rastin konkret, paditësi nuk ka argumentuar se si të paditurit e kanë shkaktuar pengimin e posedimit në cilëndo mënyrë të shfrytëzimit të palujtshmërisë së tij, për periudhën e cekur si në padi dhe sipas kërkesëpadisë së precizuar-zgjeruar, sepse nga provat në shkresë të lëndës e sidomos nga ekspertiza e gjeodezisë është vërtetuar se në ng.kat.nr.XXX-X, në vendin e quajtur „R.....“, ZK D....., ekziston tubi i betonit me profil 250 mm i kanalizimit, e që dalja e tubit nga toka është larguar nga rruga e asfaltuar në distancë 2,00 m, por që nuk ka qenë e mundur që të identifikohet se nga cila shtëpi shtrihet tubi i kanalizimit i cili derdhet në ngastrën e paditësit, ndërsa nga deklarata e paditësit dhe e dëshmitarëve, është vërtetuar se të paditurit nga paditësi e kanë blerë shtëpinë me parcelë dhe me rrjetin e rregulluar të kanalizimit, me punë juridike, Kontratën e shitblerjes të vitit 2012, ndërsa para kësaj ka ekzistuar edhe parakontrata e vitit 2008, ndaj të paditurit që nga ky vit e kanë në posedim shtëpinë e blerë nga paditësi, ndërsa sa i përket rrjetit të kanalizimit, gjithashtu është vërtetuar se palët në atë kohë ishin pajtuar që të paditurit të shfrytëzojnë këtë rrjet të kanalizimit deri në rregullimin e rrjetit qendror për tërë lagjen. Në kuptim të lartcekurve rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse të theksuara në ankesën e parashtruar, ku paditësi nuk ka ofruar ndonjë

bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, pretendimet e paditësit do të mund të shërbenin në ndonjë procedurë tjetër, por në procedurën e pengim posedimit në rastin konkret nuk është vërtetuar se të paditurit kanë ndërmarrë ndonjë veprim për lidhjen e rrjetit të kanalizimit, me të cilin do të vërtetohej akti i pengim posedimit.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur. Nga sa u tha me lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6311/2023, me datë 14.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v,